



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d**, nenit 40, paragrafi 40.2, pika **b** të Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28 qershor 2008), nenit 61, paragrafi 61.2 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nr. 03/L-048, nenit 33, paragrafi 33.1, pika **b** dhe nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 2026, merr këtë:

**V E N D I M
PËR MIRATIMIN E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE PËR PERIUDHËN
2027-2029**

- I.** Miratohet Korniza afatmesme buxhetore për periudhën 2027-2029.
- II.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Korniza afatmesme buxhetore për periudhën 2027-2029.
- III.** Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Kryeqytetit dhe Drejtoria e Financave.
- IV.** Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

**KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina**



Republika e Kosovës
Republic Kosovo – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtine
Opština Pristine –Municipality of Prishtine



Drejtoria e Financave

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE

2027-2029

Korniza afatmesme buxhetore komunale	3
Objektivat e Kornizës afatmesme buxhetore komunale	4
Objektivat e Komunës së Prishtinës	4
Objektivat e Qeverisë së Kosovës	4
Objektivat dhe përfitimet e procesit të KAB-së për komunitat	5
Objektivat	6
Struktura organizative e Komunës së Prishtinës	7
Programet.....	8
Pjesëmarrja e programeve buxhetore në grantin qeveritar 2027-2029	11
Perspektiva e politikave fiskale	11
Pjesëmarrja e granteve në buxhet, sipas viteve, 2027 – 2029	11
Parashikimi i të hyrave vetanake komunale.....	12
Plani i të hyrave vetanake komunale 2027 – 2029	14
Vlerësimet e hershme të shpenzimeve të programeve buxhetore.....	16
Grantet qeveritare dhe të hyrat vetjake 2027 – 2029.....	16
Buxheti 2026-2028 dhe deklaratat e misioneve dhe vizioneve sipas programeve buxhetore - drejtorive.....	17

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE 2027 - 2029

Korniza afatmesme buxhetore e Komunës së Prishtinës, është dokument bazik i nivelit të lartë strategjik komunal, që do të pasqyrojë caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, si dhe strukturën përkatëse sipas kategorive ekonomike, për të përmbushur objektivat e përcaktuara me Strategjinë zhvillimore afatmesme komunale. Si pjesëpërbërëse e Kornizës afatmesme buxhetore (KAB), është e përpiluar në përputhje me procedurat buxhetore 2027/2029, të dhëna nga Ministria e Financave (MF), përmes Qarkores buxhetore 2027/01 për komunat, si dhe financimi nga grantet qeveritare dhe kufijtë fillestarë të buxhetit komunal për vitin 2027 dhe parashikimet për periudhën 2028 - 2029, që janë miratuar nga Komisioni i granteve, si pjesë integrale e Kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH) 2027/2029, e miratuar nga Qeveria e Kosovës, më 15 maj 2026.

Korniza afatmesme buxhetore (KAB) komunale paraqet një mjet të procesit për zhvillimin e buxhetit, që bën ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e Komunës, duke u bazuar në qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme trevjeçare. Me Kornizën afatmesme buxhetore – komunale, do t'i paraqesim shpjegimet e politikave dhe prioritetëve të tanishme dhe afatmesme të Komunës së Prishtinës, si dhe projeksionet lidhur me mënyrën, me të cilën buxheti i Komunës do t'i përmbushë dhe përkrahë projektet me prioritet, që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitet 2027/2029, gjithnjë duke u bazuar në:

- Ligjin për financat e pushtetit lokal;
- Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë;
- Ligjin për vetëqeverisjen lokale;
- Ligjin për kufijtë administrativë komunalë.

OBJEKTIVAT E KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE

Korniza afatmesme buxhetore për periudhën 2027-2029, planifikohet në bazë të buxhetit, i cili bazohet në Buxhetin e programeve, në objektivat dhe në deklaratat e misioneve të programeve. KAB-ja komunale 2027-2029, është krijuar në përputhje me udhëzimet e Qarkores buxhetore nr. 2027/01, e cila sfond të vetin dhe kontekst ka prioritet e programeve dhe kursimet e shpenzimeve. Në KAB-në komunale paraqiten edhe deklaratat dhe misionet e drejtorive lidhur me punën e tyre pasuese trevjeçare.

❖ Objektivat e Komunës së Prishtinës:

- Mbrojtja, përmirësimi i ambientit dhe infrastrukturës së qytetit;
- Menaxhimi i arkëtimit të mbeturinave, duke ndihmuar ndërmarrjen publike për pastrim;
- Hartimi i planit zhvillimor komunal dhe planeve rregulluese në zonat urbane;
- Zhvillimi i fushës së shëndetësisë dhe mirëqenies sociale;
- Përfshirja e tërësishme në arsim parashkollor, fillor dhe të mesëm, si dhe ngritja e nivelit të arsimit;
- Zhvillimi i fushës së kulturës, rinisë dhe sportit;
- Promovimi dhe përkrahja e bizneseve të vogla dhe të mesme;
- Përkrahja e të rinjve dhe ulja e papunësisë;
- Zhvillimi i turizmit kulturor, historik dhe malor;
- Subvencionimet në bujqësi;
- Përkrahja e OJQ-ve në përgjithësi, e në veçanti organizatat e të rinjve.

❖ Objektivat e Qeverisë së Kosovës:

- Rritja dhe qëndrueshmëria ekonomike;
- Punësimi dhe mirëqenia;
- Sundimi i ligjit dhe shteti ligjor;
- Integrimet evropiane, politika e jashtme dhe çështjet e sigurisë;
- Arsimi, shkenca, kultura, rinia dhe sporti;
- Shëndetësia moderne.

❖ Objektivat dhe përfitimet e procesit të KAB-së për komunat

Përfshirja e qasjes së KAB-së në proceset e buxhetit komunal, është i motivuar nga qëllimet e mëposhtme:

- Të ofrojë kornizë gjithëpërfshirëse dhe reale për planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve buxhetore për tri vitet e ardhshme;
- Të rrisë parashikimin dhe qëndrueshmërinë e planifikimit të buxhetit, përmes futjes së parashikimit më të besueshëm të të hyrave komunale dhe shpenzimeve në perspektivë trevjeçare;
- Të përmirësojë lidhjen në mes procesit të alokimit të burimeve dhe prioriteteve të politikave komunale;
- Të fuqizohen drejtoritë komunale në shpërndarjen e burimeve, menaxhim dhe shfrytëzim;
- Të bëhet planifikimi sa më objektiv nëpër kategori ekonomike – BDMS;
- Të bëhet alokimi i mjeteve buxhetore për vitet e ardhshme sipas kategorive ekonomike;
- Planifikimi i investimeve kapitale përmes sistemit të PIP-së;
- Përfshirja e buxhetit gjinor në të gjitha fushat, si një implementim i nevojshëm për të garantuar parimin e barazisë gjinore.

Objektivat:

a) Shtimi i efikasitetit dhe efektivitetit:

Përmirësimi i efektivitetit në shpenzimin e buxhetit komunal;

- Planifikimi i buxhetit në kode dhe nënkode ekonomike;
 - Shfrytëzimi maksimal i burimeve;
 - Respektimi i afateve kohore gjatë kryerjes së punëve;
 - Kryerja e punëve në mënyrë të duhur dhe cilësore;
- Përzgjedhja e punëve me prioritet për realizim.

b) Rritja e të hyrave vetjake:

- Rritja e efikasitetit në arkëtim;
- Mundësia për zbatimin e tarifave të reja.

c) Kontrolli dhe reduktimi i shpenzimeve

- Evitimi i shpenzimeve të panevojshme;
- Planifikimi i shpenzimeve me kohë;
- Përparësia nga blerja me shumicë;
- Përmirësimi i performancës për mallra dhe shërbime;
- Planet për kursim nga shpenzimet – kontratat kornizë.

d) Ngritja e kapaciteteve njerëzore

Trajnimi për burimet dhe resurset njerëzore;

Përdorim i software-ve të avancuar për shërbime;

Profesionalizimi i shërbimeve.

e) Sigurimi i disiplinës financiare:

- Harmonizim me politikat financiare, ligjet, rregulloret dhe udhëzimet administrative;
- Ekzistenca e kontrolleve interne – auditori i brendshëm dhe zbatimi i rekomandimeve;
- Transparenca gjatë sjelljeve të vendimeve, informimi publik;
- Analiza të vazhdueshme dhe sipas kërkesave të shpenzimeve;

- Planifikimi dhe realizimi i buxhetit sipas planit të rrjedhjes së parësë së gatshme (Kesh plani);
- Planifikimi dhe realizimi i buxhetit sipas programit të BDMS – SZHMB;
- Planifikimi dhe realizimi investimeve kapitale sipas programit të PIP-së (Programi i investimeve publike);
- Respektimi i Ligjit të buxhetit - mos hyrja në obligime pa mbulesë - zotim të mjeteve.

f) Ekonomia:

- Zhvillimi i Strategjisë komunale për promovim ekonomik;
- Krijimi i kushteve të përshtatshme për donatorë të brendshëm dhe të jashtëm;
- Strategjia për zhvillimin rural;
- Strategjia për biodiversitet;
- Menaxhimi i mbeturinave.

Struktura organizative e Komunës së Prishtinës

616	KOMUNA E PRISHTINES	
1.1	160	Zyra e Kryetarit
1.1.1	16006	Zyra e Kryetarit
1.2	169	Zyra e Kuvendit të Komunës
1.2.1	16906	Zyra e Kuvendit të Komunës
1.3	163	Administrata dhe Personeli
1.3.1	16306	Administrata
1.4	166	Inspektimet
1.4.1	16611	Inspektimet
1.5	167	Prokurimi
1.5.1	16730	Prokurimi
1.6	175	Buxheti dhe financat
1.6.1	17506	Buxheti
1.6.2	17581	Tatimi ne Prona
1.7	180	Shërbimet publike, Mbrojtja civile, Emergjencia
1.7.1	18040	Investimet kapitale dhe menaxhimi i kontratave
1.7.2	18166	Infrastruktura publike
1.7.3	18230	Zjarrfikësit dhe inspektimet
1.7.4	18039	Menaxhimi i parqeve dhe hapësirave publike
1.7.5	18450	Drejtoria e Sigurisë dhe Emergjencave

1.8	195	Zyra komunale për komunitete dhe kthim
1.9	470	Bujqësia, pylltaria dhe zhvillimi rural
1.9.1	47006	Bujqësia
1.10	480	Zhvillimi ekonomik
1.10.1	48006	Planifikimi i zhvillimit ekonomik
1.11	650	Kadastri dhe gjeodezia
1.11.1	65030	Shërbimet kadastrale
1.12	660	Planifikimi urban dhe mjedisi
1.12.1	66335	Planifikimi urban dhe inspeksioni
1.13	730	Shëndetësia dhe mirëqenia sociale
1.13.1	73015	Administrata
1.13.2	73350	Shërbimet e shëndetësisë primare
1.14	755	Shërbimet sociale
1.14.1	75526	Shërbimet sociale
1.14.2	75527	Shërbimet rezidenciale
1.15	850	Kultura, rinia dhe sportet
1.15.1	85006	Shërbimet kulturore
1.15.2	85086	Sporti dhe rekreacioni
1.16	920	Arsimi dhe shkenca
1.16.1	92030	Administrata
1.16.2	92310	Arsimi parashkollor dhe çerdhet
1.16.3	93150	Arsimi fillor
1.16.4	94350	Arsimi i mesëm

Programet:

a. Shqyrtimi dhe përmirësimi i sistemeve operative dhe transparenca:

- Respektimi i procedurave të prokurimit;
- Evidenca e duhur financiare dhe procedurat e kontabilitetit;
- Inventarizimi i duhur dhe menaxhimi i pronës;
- Koordinimet në mes drejtorive – programeve buxhetore;

- Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave dhe analizat;
- Menaxhimi i bazës së të dhënave;
- Informimi publik.

b. Përmirësimi i bazës së të hyrave vetjake komunale:

- Rritja e performancës së arkëtimit të tarifave dhe taksave komunale;
- Regjistrimi i tatimpaguesve të rinj për tatimin në pronë;
- Tarifa (ngarkesa) të reja për shërbime të reja;
- Tarifa (taksa) ekonomikisht të arsyetuara;
- Ngarkesa të reduktuara (periodike).

Veprimet që kanë të bëjnë me objektivat:


- Kontrolli për parandalimin e ndërtimit ilegal të shtëpive dhe objekteve të tjera;
- Procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje;
- Zbatimi dhe respektimi i rregulloreve komunale;
- Shqyrtimi i Planit të punës 2027;
- Përgatitja e buxhetit dhe planit të punës për vitin 2027;
- Përgatitja e Kornizës afatmesme buxhetore 2027-2029;
- Përgatitja e qarkoreve interne komunale;
- Mbajtja e dëgjimeve buxhetore me qytetarë;
- Përgatitja e planeve rregulluese dhe detaje;
- Përmirësimi i mbledhjes bazike të të dhënave dhe analiza e tyre;
- Shqyrtimi i përgjegjësisë dhe i obligimeve komunale;
- Menaxhimi i projekteve;
- Menaxhimi i bazës së të dhënave;
- Monitorimi;
- Vlerësimi;

1.1. Korniza makroekonomike

Korniza makroekonomike është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas kriterëve të Kornizës afatmesme buxhetore (KAB).

Pjesëmarrja e programeve buxhetore në totalin e grantit qeveritar 2026.

Komuna	Granti i përgjithshëm	Granti specifik për Arsim	Granti specifik për Shëndetësi	Ligji për Kryeqytet	Të hyrat vetjake	Gjithsej financimi 2027
Prishtinë	52,690,420	31,801,112	10,204,508	22,225,688	44,173,910	161,095,638



2. Përfshirja e granteve në buxhetin e përgjithshëm sipas viteve 2027 – 2029

2.1. Perspektiva e politikave fiskale

Një vëmendje e veçantë duhet kushtuar politikave fiskale, politikës së të ardhurave, si nga granti i Qeverisë, të hyrave vetjake komunale dhe shpenzimeve. Me Kornizën afatmesme buxhetore 2027 – 2029, e cila është miratuar nga Qeveria e Kosovës, më 15.05.2026, bazuar në prioritetet afatmesme të Qeverisë dhe Kornizës makrofiskale 2027-2029, Qeveria është përkushtuar që duke e ruajtur stabilitetin fiskal, të përkrahë edhe kërkesat e organizatave buxhetore, duke paraparë ndërmarrjen e një varg masash, që nga kursimet në kategorinë e shpenzimeve operative – si rezultat i rekomandimeve të FMN-së , e deri te marrja e masave konkrete në realizimin e të hyrave në nivel qendror dhe lokal, si:

- Kontroll më efikas dhe mbledhje e detyrueshme për ngarkesat dhe tarifat e mbledhura në nivel lokal;
- Sensibilizim i qytetarëve për të kryer obligimet ndaj Komunës;
- Zyrat komunale të tatimit në pronë, udhëzohen të bëjnë rekomandimet e tyre në vendosjen e zonave të vlerësimit të normave tatimore, nivelin e përpjekjeve në mbledhjen e tatimit në pronë, me qëllim të arritjes së të hyrave të planifikuara të tatimit në pronë të paraparë me projektbuxhet.

Parashikimi i të hyrave vetjake të Komunës së Prishtinës për periudhën 2027-2029

Të hyrat komunale të Komunës së Prishtinës realizohen në bazë të Ligjit mbi financat e pushtetit lokal, Rregullores mbi tarifat dhe ngarkesat komunale, Rregullores mbi tatimin në pronë, si dhe dispozitave tjera ligjore, të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të të hyrave komunale, me të cilat Komuna ka të drejtë të caktojë dhe arkëtojë të hyra të tjera komunale.


Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë tatimi në pronë dhe të hyrat nga lejet e ndërtimit, të cilat të hyra duhet shpenzuar, dhe ekskluzivisht dedikohen në fushën e projekteve dhe investimeve kapitale në infrastrukturën rrugore, ujësjellës, kanalizim dhe investime të tjera, gjë që ju kthehen qytetarëve (tatimpaguesve) në investime dhe ngritjen e infrastrukturës publike komunale.

Të hyrat e Komunës për periudhën 2027-2029, parashihet të arkëtohen nga:

- Tatimi në pronë
 - Tatimi në tokë,
 - Taksa për mbeturina,
- Taksat për leje ndërtimi,
- Taksat administrative komunale,
- Taksat për ushtrim të veprimtarisë afariste,
- Taksat për lejen për shërbime profesionale,
- Taksat për automjete motorike,
- Taksat nga kadastri dhe gjeodezia,
- Taksat për certifikata,
 - Participim në Arsim,
 - Participim në Shëndetësi,
 - Të hyra të tjera.

KOMUNA	Taksat, ngarkesat dhe të hyrat tjera jo tatimore	Të hyrat nga tatimi në pronë	Projeksionet për vitin 2027
PRISHTINË	27,532,405	16,641,506	44,173,910

TË HYRAT VETJAKE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS PËR VITIN 2027



■ Taksat, ngarkesat dhe të hyrat tjera jo tatimore

■ Të hyrat nga tatimi në pronë

Taksa komunale për leje ndërtimi, është gjithashtu një kategori e rëndësishme e të hyrave. Gjatë planifikimit të kësaj të hyre, Komuna ende nuk është e sigurt me gjendjen e legalizimeve të objekteve të ndërtuara pa leje. Të gjitha objektet që nuk janë të legalizuara, por janë pjesë e planit urban, do të legalizohen, po ashtu me miratimin e Ligjit mbi tatimin në tokë, gjatë vitit 2027, të rritet arkëtimi i THV-së.

Me qëllim të rritjes së të hyrave vetjake, Komuna do të formojë një ekip për ngritjen e performancës së të hyrave vetjake për vitet e ardhshme.

Parashikimi i të hyrave buxhetore komunale 2027 – 2029

Nr.	PËRSHKRIMI	2027	2028	2029
1	Taksa për leje ndërtimi	12,012,404	12,963,519	14,011,182
2	Legalizimi i ndërtimeve pa leje	450,000	450,000	550,000
3	Leje mjedisore komunale	820,000	840,000	950,000
4	Tatimi në pronën e paluajtshme dhe tokë	16,641,506	16,789,386	16,873,333
5	Menaxhimi i mbeturinave	200,000	200,000	200,000
6	Taksa tjera te planifikuara	4,100,000	4,200,000	4,400,000
7	Licenca në biznes	550,000	550,000	600,000
8	Taksa për shfrytëzimi i sip. publike	300,000	350,000	400,000
9	Konfiskimi i veturave - me merimangë	150,000	200,000	250,000
10	Infrastrukturë rrugore	3,800,000	4,000,000	4,500,000
11	Taksa nga kadastri dhe gjeodezia	1,400,000	1,400,000	1,500,000
12	Të hyra nga inspekcioni	300,000	300,000	400,000
13	Taksa për certif.dhe doku.zyrtare	300,000	300,000	350,000
14	Taksa për automjete motorrike	900,000	900,000	900,000
15	Taksa për shërbime arsimore	800,000	800,000	850,000
16	Biblioteka dhe teatri "Dodona"	20,000	20,000	20,000
17	Taksa për shërbime shëndetësore	400,000	400,000	400,000
18	Të hyrat tjera te pa përcaktuara	15,000	15,000	15,000
19	Shitja e pasurisë	15,000	15,000	15,000
20	Shpronësime	1,000,000	1,000,000	1,000,000
Gjithsej		44,173,910	45,692,905	48,184,515

Parashikimi i të hyrave buxhetore 2027 - 2029

Të hyrat vetjake **44,173,910.00 euro** të planifikuara për vitin 2027, do të arkëtohen kryesisht nga taksa për leje ndërtimi, taksa për infrastrukturë rrugore, tatimi në pronën e paluajtshme, tatimi në tokë, nga legalizimi i ndërtimeve pa leje dhe nga taksat tjera te planifikuara. Burime sekondare të të hyrave do të jenë edhe të hyrat nga shpronësimet e tokave komunale dhe taksa për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike. Vlerësimet e mbështetjes së pritur të donatorëve dhe agjencive qeveritare ndërkombëtare, përfshirë bashkëfinancimin e mundshëm, janë përfshirë në kuadër të të hyrave nga participimet dhe donacionet.

Vlerësimet e hershme të shpenzimeve të programeve buxhetore

Në vlerësimet e hershme të shpenzimeve buxhetore, përfshihen kornizat e shpenzimeve të secilit program buxhetor, duke u bazuar në burimet e të hyrave dhe duke u modifikuar vetëm nga treguesit makro-ekonomik dhe fiskal, dhe duke pasur për bazë buxhetin e miratuar për vitin 2027 dhe shpenzimet gjatë viteve të fundit. Kjo kornizë paraqet parashikimin trevjeçar të shpenzimeve të përgjithshme komunale.

Të hyrat komunale janë paraqitur me një trend të rritjes për çdo vit, si dhe të granteve të Qeverisë, të cilat më pastaj do të inkorporohen në vlerësimet pasuese të shpenzimeve buxhetore sipas qarkoreve buxhetore dhe limiteve të buxhetit, të cilat do të përcaktohen nga Komisioni i granteve të MF-së.

Grantet qeveritare dhe të hyrat vetjake komunale 2027 - 2029

Në vazhdim janë paraqitur granti i përgjithshëm, granti specifik për kryeqytetin, granti specifik i Arsimit, granti specifik për Shëndetësi, dhe plani i të hyrave vetanake komunale sipas viteve 2027 – 2029 .

Tabela 1: Vlerësimet e burimeve të financimit për Komunën e Prishtinës (2026-2029)

Burimet e financimit	Buxheti aktual	Buxheti i planifikuar	Parashikimet e hershme ¹	
	2026	2027	2028	2029
Grandi i përgjithshëm	46,029,108	50,660,400	52,851,184	56,925,326
Grandi specifik për Arsim	30,932,322	31,801,112	32,755,145	33,737,800
Grandi specifik për Shëndetësi	12,115,627	10,204,508	10,510,644	10,825,963
Grandi specifik për Kryeqytetin	20,311,620	22,225,688	23,895,797	25,770,411
Të hyrat vetjake	41,144,772	44,173,910	45,692,905	48,184,515
Financim nga huamarrja	2,000,000	2,030,020	-	-
Gjithsej	151,533,499	161,095,638	165,705,675	175,444,015

Tabela 2: Planifikimi i shpenzimeve për Komunën e Prishtinës (2026-2029)

Kategoritë e shpenzimeve	Buxheti aktual	Buxheti i planifikuar	Parashikimet e hershme	
	2026	2027	2028	2029
Paga dhe mëditje	48,361,456	50,000,000	53,000,000	55,000,000
Mallra dhe shërbime	32,000,000	34,000,000	36,000,000	38,000,000
Shpenzime komunale	3,500,000	3,700,000	4,000,000	4,200,000
Subvencione dhe transfere	6,800,000	7,300,000	7,500,000	7,800,000
Investime kapitale	60,871,992	66,095,638	65,205,675	70,444,015
Gjithsej	151,533,499	161,095,638	165,705,675	175,444,015

Propozimet e projekteve për Investimeve kapitale për vitet 2027- 2029, janë si në vijim:

Nr.	Drejtoria e Investimeve Kapitale/Drejtoria e Transformimit	2027	2028	2029
1	"Rruga A" - vazhdim i "Rr. A" (pjesa Kalabri)	1,525,915.00		
2	Ndërtimi i rr. në Mramor	150,000.00		
3	Ndërtimi i rr. "Holgen Petersen"	350,000.00	500,000.00	550,000.00
4	Ndërtimi i rr. mbi Kolektorin Kalabri (nga ujësjellësi-unazë deri në përfundim të kolektorit ekzistues)	350,000.00	500,000.00	500,000.00
5	Furnizimi me ujësjellës përmes puseve dhe rezervuareve për fshatrat e Gollakut	250,000.00	350,000.00	300,000.00
6	Rikonstruimi i instalimeve nëntokësore dhe hapësirës publike tek Qendra Zejtare te Prishtina e Vjetër	300,000.00	500,000.00	450,000.00
7	Rikonstrumi infrastrukturor i varrezave	400,000.00	500,000.00	100,000.00
8	Kontrata "në shtëpi" për shërbime urgjente të mirëmbajtjes dhe riparimeve në ndërtesa dhe hapësira të jashtme - Komuna e Prishtinës	1,000,000.00	1,000,000.00	1,000,000.00
9	Ndërtimi i kanalizimeve në qytet (bashkëinvestim)	2,000,000.00	2,000,000.00	3,000,000.00
10	Intervenime infrastrukturore për persona me nevoja të veçanta	100,000.00	100,000.00	200,000.00
11	Ndërtimi i kanalizimeve në fshatrat e Prishtinës: Bardhosh, Prugoc Barilevë, Besi, Busi, Dabishec, Drenoc, Glogovicë, Hajkobilë, Grashticë, Hajvali, Lebanë, Llukar, Makoc, Mat, Mramor etj	800,000.00	300,000.00	500,000.00
12	Ndërtimi i rrugëve të reja në lagjet e Prishtinës ("Ndue Përlleshi", "Bahti Shala", "Abush Loku", "Bregu i Diellit", "Hajvali", "Sofali", "Kalabri", "Dardani", "Ulpianë", etj.)	1,000,000.00	500,000.00	600,000.00
13	Ndërtimi i rrugëve nëpër fshatrat e kryeqytetit	500,000.00	550,000.00	1,000,000.00
14	Ndërtimi i rrugëve me zhavorr në fshatra	300,000.00	300,000.00	300,000.00
15	Depërtimi i "Rrugës A" në Veternik	100,000.00	2,000,000.00	1,000,000.00
16	Ndërtimi dhe rikonstruimi, sanimi i rrugëve në zona (I- V)	1,000,000.00	700,000.00	500,000.00
17	Ndërtimi i urave - drejtimi Fushë Kosovë dhe Mitrovicë	500,000.00	1,000,000.00	500,000.00
18	Struktura betoni për siguri nga shembjet - mure	100,000.00	200,000.00	300,000.00

19	"Rruga A" - vazhdimi që lidhet me "Rrugën C"	200,000.00	500,000.00	1,500,000.00
20	<i>Rregullimi i sheshit "Xhorxh Bush"</i>	9,450,000.00	3,250,000.00	
21	<i>Ndërtimi i ishullit urban Arbëri - Pallati i Rinisë</i>	1,000,000.00	3,350,000.00	1,000,000.00
22	<i>Ndërtimi i nënkalimit për vetura në rrugën "Agim Ramadani"</i>	800,000.00	500,000.00	1,000,000.00
23	Ndërtimi i torotuaeve të sigurta për këmbësorë në rrugët ekzistuese	350,000.00	500,000.00	900,000.00
24	Platforma Pallati i Rinisë - Grand Hotel	100,000.00	450,000.00	1,000,000.00
25	Platforma Ishulli Aktash - Qendra Studentore	150,000.00	500,000.00	500,000.00
26	Punimi i projektit të platformës Dardani - Kalabri	200,000.00	400,000.00	400,000.00
27	Ndërtimi i infrastrukturës rrugore Bardhosh - Bërrnicë - Trudë	600,000.00	400,000.00	-
28	Platformë për t'u lidhur lagjja "Aktash" me zonën e Qendrës së Studentëve dhe qendrës së qytetit	-	1,000,000.00	2,500,000.00
29	Ndërtimi i tubacionit sipas MOU me Komunën e Obiliqit	850,000.00	200,000.00	
30	Zgjerimi i sheshit "Xhorxh Bush" deri te rrethi i flamurit		1,000,000.00	2,500,000.00
31	Revitalizimi i Qendrës Tregtare në Bregun e Diellit	450,000.00	450,000.00	
32	Rregullimi i platove në Bregun e Diellit dhe Dardani	350,000.00	350,000.00	350,000.00
33	Vazhdimi i "Rrugës A" deri në Zllatar		1,000,000.00	2,500,000.00
34	Ndërtimi i tregjeve në kryeqytet	1,000,000.00	1,500,000.00	1,000,000.00
35	Ndërtimi i rrugës "Bajram Bahtiri" faza e II-të	1,000,000.00		
	Totali	27,225,915.00	26,350,000.00	25,950,000.00

Sqarim: Drejtoria e Investimeve Kapitale menaxhon dhe mbikëqyrë ndërtimet e ulëta kurse Drejtoria e Transformimit , menaxhon dhe mbikëqyrë ndërtimet e larta (objektet) ne bashkëpunim me drejtorit përkatëse.

Nr.	Drejtoria e Kulturës	2027	2028	2029
1	Muzeu, shtëpitë shkolla Prishtinë - te Herticët	450,000.00	200,000.00	-
2	Dizajnimi dhe ndërtimi i Muzeut të Paqes	100,000.00	-	-
3	Salla koncertale	1,000,000.00	2,000,000.00	5,000,000.00
4	Ndërtimi dhe konkursi për "Memorialin Adem Jashari"	500,000.00	500,000.00	
5	"Biblioteka dhe Memoriali - dr. Ibrahim Rugova"	500,000.00	550,000.00	500,000.00
6	Ndërtimi i memorialit kushtuar aktorit Faruk Begolli	100,000.00	-	-
7	Rikonstruimi i "Kino Rinisë"	350,000.00	500,000.00	500,000.00
8	Ndërtimi i Qendrës kulturore për zhvillimin e krijuesve të rinj	100,000.00	500,000.00	400,000.00
9	Dizajnimi dhe ndërtimi i Qendrës kulturore në Hajvali	100,000.00	400,000.00	500,000.00
10	Dizajnimi dhe ndërtimi i hapësirave multifunksionale kulturore (parku i qytetit, Arbëri, Dardani, Ulpianë, Bregu i Diellit)	150,000.00	150,000.00	150,000.00
11	Rivitalizimi i hapësirave publike kulturore (Ulpianë, Bregu i Diellit, Kolovicë)	200,000.00	400,000.00	450,000.00
12	Rivitalizimi i objektit në Kolovicën e Vjetër dhe funksionimi në Qendër të kulturës "Escape space"	100,000.00	100,000.00	100,000.00
	Totali	3,650,000.00	5,300,000.00	7,600,000.00

Nr.	Drejtoria e Shërbimeve Publike	2027	2028	2029
1	Ndërtimi, zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik	1,400,000.00	1,500,000.00	2,000,000.00
2	Ndërtimi dhe funksionalizimi i kontejnerëve nëntokësorë dhe gjysmëntokësorë	500,000.00	550,000.00	1,000,000.00
3	Rregullimi dhe ndërtimi i ashensorëve në zonat urbane të kryeqytetit	500,000.00	400,000.00	400,000.00
4	Ndërtimi dhe rikonstruimi i fontanave të qytetit	50,000.00	100,000.00	200,000.00
5	Furnizimi me pajisje dhe makineri për pastrimin e qytetit	300,000.00	200,000.00	200,000.00
6	Rregullimi i pikës transfer për mbeturina vëllimore dhe inerte	150,000.00	200,000.00	250,000.00

7	Zgjerimi i ndërtimit të Qendrës së qenve endacakë, impiantit për trajtimin e ujërave të zeza dhe furnizimi me ujë të pijes	450,000.00	500,000.00	500,000.00
8	Dizajnimi dhe ndërtimi i parkingjeve nëntokësorë (Bregu i Diellit, Dardani)	350,000.00	400,000.00	450,000.00
9	Ndërtimi dhe rregullimi i varrezave	500,000.00	500,000.00	500,000.00
10	Ndërtimi, rregullimi, vendosja dhe pastrimi i lumenjve dhe kanalizimeve	400,000.00	250,000.00	300,000.00
11	Efiçienca e energjisë në ndërtesat publike në Prishtinë	1,000,000.00		
	Totali	5,600,000.00	4,600,000.00	5,800,000.00

Nr.	Drejtoria e Administratës	2027	2028	2029
1	Renovimi i tërësishëm i objektit të Komunës së Vjetër dhe oborrit (lidhje me sheshin "Adem Jashari")	300,000.00	250,000.00	350,000.00
2	Renovimi i sallës së Asamblesë komunale	800,000.00	-	-
3	Inventarizimi i arkivës komunale, sistemi kundër zjarrit dhe ventillimi në arkivat e objekteve komunale	200,000.00	150,000.00	
4	Renovimi i objekteve komunale dhe bashkësive lokale	300,000.00	300,000.00	200,000.00
	Totali	1,600,000.00	700,000.00	550,000.00

Nr.	Drejtoria e Parqeve	2027	2028	2029
1	Ndërtimi i parqeve, hapësirave gjelbëruese dhe krijimi i hapësirave të reja rekreative në Komunën e Prishtinës	1,500,000.00	1,600,000.00	1,800,000.00
2	Ndërtimi i sistemit të ujitjes në hapësira gjelbëruese dhe parqe, si dhe hapja e puseve	350,000.00	400,000.00	450,000.00
3	Furnizimi me lodra për parqe dhe krijimi i hapësirave të reja rekreative	400,000.00	400,000.00	450,000.00
4	Ndërtimi i parkut të "Kodra e Trimave"	200,000.00	250,000.00	
5	Ndërtimi dhe shndërrimi i oborreve të shkollave në parqe e të qasshme	250,000.00	300,000.00	300,000.00
6	Blerja e mekanizmit për mbjelljen, transportimin dhe vendosjen drunjëve të mbëdhenjë dhe fidaneve	1,012,111.00	-	-

7	"Parku Bardha" (faza I, II, III)	300,000.00	350,000.00	400,000.00
8	Ndërtimi i shtigjeve të reja për ecje, vrapim dhe ciklizëm, në parqet ekzistuese dhe të reja	200,000.00	250,000.00	300,000.00
9	Mobileria urbane (shporta, ulëse, ndriçim, rrethoja, mbajtëse)	650,000.00	450,000.00	500,000.00
10	Furnizim me fidane shumëvjeçare në parqet dhe hapësirat publike të kryeqytetit	200,000.00	-	-
11	Ndërtimi i Parkut Rekreativ të Biodiversitetit (zona e polinatorëve, bimët autoktone, kullat e vrojtimit për zogj)	130,000.00	150,000.00	170,000.00
12	Ndërtimi i parkut dhe tregut të luleve në Zonën Qendër	250,000.00	300,000.00	200,000.00
TOTALI		5,442,111.00	4,450,000.00	4,570,000.00

Nr.	Drejtoria e Zhvillimit Rural dhe Bujqësisë	2027	2028	2029
1	Ndërtimi i Thertores publike dhe Tregut të kafshëve	1,300,000.00	1,077,777.78	
2	Rehabilitimi i rrugëve fushore	50,000.00	100,000.00	
3	Ndërtimi i deponive të produkteve bujqësore (Barilevë, Mramor)	200,000.00	200,000.00	100,000.00
TOTALI		1,550,000.00	1,377,777.78	100,000.00

Nr.	Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë	2027	2028	2029
1	Zgjerimi i rrjetit të sistemit të kamerave në kryeqytet	400,000.00	400,000.00	400,000.00
2	Renovimi i objektit për zjarrfikësit vullnetarë	100,000.00	100,000.00	-
3	Ndërtimi i shkallëve emergjente në institucionet publike	150,000.00	150,000.00	150,000.00
4	Zgjerimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të sistemit të kamerave në të gjitha institucionet e kryeqytetit	600,000.00	450,000.00	250,000.00
Totali		1,250,000.00	1,100,000.00	800,000.00

Nr.	Drejtoria e Shëndetësisë	2027	2028	2029
-----	--------------------------	------	------	------

1	Renovimi i infrastrukturës i objekteve të shëndetësisë primare	500,000.00	550,000.00	450,000.00
2	Punkti i ri për QMU në QMF - 6 dhe inventarizimi për nevojat e objekteve të shëndetësisë primare	320,000.00	350,000.00	400,000.00
3	Furnizim me pajisje mjekësore për nevojat e shëndetësisë primare	250,000.00	250,000.00	250,000.00
4	Furnizim me autovetura për nevojat e shëndetësisë primare	150,000.00	200,000.00	200,000.00
5	Ndërtimi i Spitalit të Prishtinës	50,000.00	200,000.00	400,000.00
	Totali	1,270,000.00	1,550,000.00	1,700,000.00

Nr.	Drejtoria e Mirëqenies Sociale dhe Rezidenciale	2027	2028	2029
1	Financimi për shtëpitë e komunitetit për persona të moshuar (SHKPM)	900,000.00	1,000,000.00	1,000,000.00
2	Financimi për shtëpitë e komunitetit për personat me aftësi të kufizuar (SHKPAK)	230,000.00	200,000.00	200,000.00
3	Financimi i shtëpive për mbrojtjen e fëmijëve (SHEMF)	152,500.00	215,000.00	215,000.00
4	Ndërtimi i Qendrës për punë sociale dhe furnizimi me inventar	1,885,112.00		
	Totali	3,167,612.00	1,415,000.00	1,415,000.00

Nr.	Drejtoria e Arsimit	2027	2028	2029
1	Ndërtimi i Liceut Artistik	1,000,000.00	3,000,000.00	4,000,000.00
2	Ndërtimi i çerdheve (Barlievë, Hajvali ose "Gëzimi Ynë" dhe "Lulevera")	1,500,000.00	2,500,000.00	4,000,000.00
3	Ndërtimi i shkollës të "Përroi i njelmët" në Mat dhe Shkabaj	2,500,000.00	3,000,000.00	3,000,000.00
4	Ndërtimi i anekseve për mësim tërëditor	450,000.00	700,000.00	700,000.00
5	Renovime dhe mirëmbajtje e shkollave (gëlqerosje, dyshe, kulme, dyer e dritare etj.)	1,500,000.00	1,000,000.00	2,500,000.00
6	Rregullimi i oborreve dhe terreneve sportive	350,000.00	400,000.00	400,000.00
7	Furnizimi me inventar për shkolla	150,000.00	150,000.00	250,000.00
8	Furnizimi me pajisje të teknologjisë informative	300,000.00	200,000.00	-

9	Pajisja e shkollave me rekuizita sportive dhe pajisje tjera sportive	80,000.00	100,000.00	100,000.00
10	Instalimi dhe mirëmbajtja e elektrikës, gjeneratorëve, klimave dhe ventilimit	150,000.00	150,000.00	150,000.00
11	Instalimet dhe renovimet e ngrohjes qendrore në IEAA	100,000.00	100,000.00	100,000.00
12	Siguria në ambientet shkollore, sistemi i alarmit, hyrje - daljet	350,000.00	250,000.00	100,000.00
14	Pajisje për laboratorë për shkenca dhe kabinetet profesionale	120,000.00	200,000.00	200,000.00
15	Ndërtimi i kampusit për shkollat e mesme të larta	150,000.00	200,000.00	
17	Renovimi i hapësirave të nyjeve sanitare	250,000.00	400,000.00	400,000.00
	Totali	8,950,000.00	12,350,000.00	15,900,000.00

Nr.	Drejtoria e Turizmit	2027	2028	2029
1	Ndërtimi i sinjalistikës dhe infrastrukturës turistike	200,000.00	250,000.00	250,000.00
2	Krijimi i qendrave të vizitorëve dhe promovimit turistik	150,000.00	200,000.00	-
	Totali	350,000.00	450,000.00	250,000.00

Nr.	Drejtoria e Sportit	2027	2028	2029
1	Ndërtimi i terreneve dhe hapësirave sportive ne Komunën e Prishtinës dhe renovimi i atyre ekzistuese	600,000.00	500,000.00	700,000.00
2	Ndërtimi i tribunës KF "Ramiz Sadiku"	200,000.00	200,000.00	-
3	Finalizimi i tribunës KF "2 Korriku"	200,000.00	200,000.00	-
4	Ndërtimi i tribunës për klubin KF "Rilindja"	200,000.00	200,000.00	-
5	Ndërtimi i sallës multifunksionale	-	-	-
6	Ndërtimi i shtigjeve për vrapim	200,000.00	200,000.00	250,000.00
7	Ndërtimi i tualeteve dhe dhomave të zhveshjes në fushat e futbollit të FC "Prishtina" dhe KF "Kosova e Prishtinës" në Bërrnicë	100,000.00	100,000.00	100,000.00

9	Ndërtimi i fitneseve natyrale në parqe dhe kënde strategjike të Prishtinës	250,000.00	300,000.00	350,000.00
11	Ndërtimi i fushave të tenisit dhe padelit	200,000.00	200,000.00	200,000.00
12	Ndërtimi i tribunës Flamurtari	200,000.00		
13	Renovimi i terreneve multifunksionale të fushave në Gërmi	250,000.00	100,000.00	70,000.00
14	Ndërtimi i shtigjeve të biçikletave në Gollak	200,000.00	120,000.00	80,000.00
15	Ndërtimi i pistës së parë zyrtare të atletikës në Prishtinë	200,000.00	200,000.00	200,000.00
16	Ndërtimi i race track	200,000.00	200,000.00	200,000.00
17	Ndërtimi i mureve alpine	50,000.00	75,000.00	
	Totali	3,050,000.00	2,595,000.00	2,150,000.00

Nr.	Drejtoria e Mobilitetit	2027	2028	2029
1	Ndriçim sinjalizues për vendkalime për siguri, ndërtimi dhe modernizimi i semaforëve, shtyllat antiparking dhe pistonët lëvizës	400,000.00	400,000.00	500,000.00
2	Sinjalizimi horizontal dhe vertikal	350,000.00	250,000.00	500,000.00
3	Ndërtimi i rrethojave për siguri në mobilitet	400,000.00	500,000.00	550,000.00
4	Ndërtimi i Qendrës digjiitale për memaxhimin e trafikut në kryeqytet	240,000.00	100,000.00	-
	Totali	1,390,000.00	1,250,000.00	1,550,000.00

Nr.	Drejtoria e Rinisë	2027	2028	2029
1	Rivitalizimi i qendrave rinore multifunksionale	250,000.00	490,000.00	490,000.00
	Totali	250,000.00	490,000.00	490,000.00

Nr.	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Inovacionit	2027	2028	2029
-----	---	------	------	------

1	Digjitalizimi i administratës publike	300,000.00	250,000.00	450,000.00
2	Digjitalizimi i parqeve (me teknologji inovative)	150,000.00	100,000.00	450,000.00
3	Ndërtimi, softveri i menaxhimit elektronik të shkollave dhe DKA-së dhe transformimi digjital i arsimit	400,000.00	200,000.00	300,000.00
4	Digjitalizimi i shërbimeve, kërkesave dhe ankesave për shërbimet publike	150,000.00	250,000.00	200,000.00
5	Digjitalizimi i shërbimeve në mes të gjitha drejtorive komunale	350,000.00	500,000.00	150,000.00
6	Qendra "Future Hubs" për punë të përbashkëta, inovacion dhe qasje të përbashkëta	100,000.00	100,000.00	100,000.00
	Totali	1,350,000.00	1,300,000.00	1,650,000.00

Sqarim :

Këto projekte të propozuara mund të ndryshojnë me raportin e përpunimit të buxhetit 2027, pas pranimit të Qarkores së dytë nga MF (2027/02), ku përcaktohen kufijtë buxhetor dhe dëgjimeve publike me qytetarët e Kryeqytetit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



PROPOZIM

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d**, të Ligjit nr. 03/ L – 040, për vetëqeverisje lokale dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur me .2026, merr këtë

V E N D I M

1. MIRATOHET ndarja e mjeteve financiare për Ndërmarrjen Publike “Prishtina Parking”, SHA.
2. Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës 1 të këtij vendimi, është € , shumë kjo e siguruar nga
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Kryeqytetit dhe Drejtoria e Financave.
5. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** të Ligjit nr. 03/L– 40, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/04, qershor 2008), të dispozitave të nenit 5, paragrafi 5.2 dhe nenit 8, paragrafi 8.2 të Ligjit nr. 03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Krejtë, në mbledhjen e mbajtur më .2026, merr këtë:

**VENDIM
PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E VENDIMIT PËR CAKTIMIN E
ANËTARËVE NË KOMISIONET E AKSIONARËVE TË NDËRMARRJEVE PUBLIKE
TË KOMUNËS SË PRISHTINËS**

CAKTOHEN anëtarët e komisioneve të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale të Komunës së Prishtinës: Kompania rajonale e mbeturinave “Pastrimi”, SHA; Ndërmarrja Publike Banesore, SHA; Ndërmarrja Publike “Gjelbërt”, SHA; Ndërmarrja Publike “Prishtina Parking”, SHA.

I.

Anëtarë të komisioneve të cekur në pikën I të këtij vendimi janë:

1. Kompania rajonale e mbeturinave “Pastrimi”, SHA:

- 1.
- 2.

2. Ndërmarrja Publike Banesore, SHA:

- 1.
- 2.

3. Ndërmarrja Publike “Gjelbërt”, SHA:

- 1.
- 2.

4. Ndërmarrja Publike “Prishtina Parking”, SHA:

- 1.
- 2.

II.

Komisionet komunale të aksionarëve kanë të drejtë të veprojnë në emër të Komunës dhe duhet të veprojnë në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare.

III.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohen pjesët e Vendimit **nr. 01-020/04-62668/22**, i dt. **21.3.2022** lidhur me këto NPL, Vendimi **nr. 01-020/04-122005/24**, i dt. **16.9.2024** dhe Vendimi me **nr. 01-020/04-121999/24**, i dt. **16.9.2024** lidhur me emërimin e anëtarëve në komisionet komunale të aksionarëve.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e kryeqytetit.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
, më .2026

KRYESUES I KUVENDIT
Fehmi Kupina